



KËRKESË PËR OFERTIM
REQUEST FOR OFFER

Titulli i projektit / Project Title:	European youth in education and in transition to labour market; Edu-Lab
Titulli i aktivitetit / Activity Title:	Blerje e paisjeve per qellim te implementimit te projektit
Numri i referencës së projektit / Project Reference Number	Horizon Europe (HE) #101177428
Agjencia donatore / Sponsoring Agency:	Research Execution Agency (REA)
Periudha e implementimit të projektit/ Project Implementation Period:	1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027

1. Informata rreth Kolegjit AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë i cili është themeluar menjëherë pas luftës në Kosovë, pas krijimit të rrethanave të reja ekonomike-sociale e kulturore, kur u krijuan kushte dhe rrethana për jetë normale të qytetarëve të Kosovës. Në fillimet e tij institucioni ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv duke u zgjeruar vazhdimisht me programe studimore në fushat e tjera dhe duke u shndërruar kështu në institucion model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Sot, Kolegji AAB ofron programe studimi të nivelin baçelor dhe master në 14 fakultete të ndryshme. Njëkohësisht, Kolegji AAB është implementues i shumë projekteve ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

2. Informata të përgjithshme rreth projektit

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të projektit **“EDULAB: Të rinjtë e Evropës në arsim dhe në kalim në tregun e punës” (European youth in education and in transition to the labour market)**. Projekti ka për qëllim të analizojë shtigjet e tranzicionit në mes të niveleve të ndryshme të arsimit (të përgjithshëm dhe profesional) dhe nga arsimi në tregun e punës. Projekti do të analizojë dhe dizajnojë mekanizma për matjen e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemeve të arsimit me qëllim të identifikimit të rrugëve më fleksibile për kalim të të rinjve në tregun e punës.

Projekti parasheh aktivitetet në vijim:

- Modelimi i shtigjeve dhe tranzicioneve në arsimin e përgjithshëm / në arsimin profesional dhe në tregun e punës;
- Vlerësimi i efikasitetit të politikave dhe investimeve në AP dhe AAP;
- Analiza e të dhënave sasiore në arsimin evropian dhe anketa ndërkombëtare e ekspertëve;
- Dëgjimi i zërave të të rinjve: Raste studimore cilësore;
- Sinteza e kërkimit, integrimi dhe rekomandimet për politikën dhe praktikën; dhe
- Shpërndarja, shfrytëzimi dhe aktivitetet e komunikimit me publikun.

Projekti financohet nga programi Horizon Europe i Bashkimit Evropian.



3. Objekti i ofertës

Të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë mund të dorëzojnë ofertat e tyre për pajisjet e listuara në vijim:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve	Specifikat teknike të pajisjeve	Sasia
1	Laptop	I7, 16GB RAM, 512GB SSD, 15.6", NVIDIA GTX 1650 / RTX 3050 / AMD Radeon RX 6500M.	1
2	Laptop	I5, 8GB RAM, 512GB SSD, 15.6", NVIDIA GTX 1650 / RTX 3050 / AMD Radeon RX 6500M.	2
3	Tablet	8GB RAM, 128GB Storage memory, 5100 mAh, 8.7", Octa-Core, Android	2
4	Kamerë lëvizëse me mikrofon	4K, covering a wide field of view 80°, Auto Framing, WIFI, Integrated with Audio, multiple installation options, 12 x optical zoom, 3 x digital zoom, smooth control by remote control, Maximum FPS 30FPS, video output 4K30, 1080p30, 720p30, Auto Focus, System Requirements: Windows 7 or higher.	1
5	Printer dhe skaner	Up to 300 sheet paper capacity, USB, wireless and gigabit wired network, 31ppm print speed mono, 28ipm scan speed colour & mono, Up to 3,000 black toners inbox.	1
6	Smart TV	Android, 86", 12GB RAM, MIN 128GB Storage memory, Refresh Rate: 120Hz, CPU: Octa-core, WIFI, USB Ports: At least 2 USB 3.0 + 1 USB-C, HDMI Ports: At least 3 HDMI 2.1 ports, Camera Support, Ethernet: Gigabit LAN, Brightness: At least 400-600 nits, Resolution: 4K UHD.	1

4. Kushtet dhe kriteret për aplikim

Të gjitha bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ofertën financiare (bazuar në specifikat, çmimin e ofruar për njësi dhe kohën e liferimit).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Certifikatën e TVSH-së

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në formë elektronike në email-in dardan.krekaj@universitetiaab.com dhe projects@universitetiaab.com me subject "Ofertë për "Edu-Lab" ose fizikisht në Zyrën për Furnizime në kolegjin AAB. Çdo formë tjetër e dorëzimit të ofertave do të konsiderohet e papranueshme.

Afati për dorëzimin e ofertave është më 05.03.2025, në ora 16.00.

Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në bazë të kriterëve si në vazhdim: çmimit ekonomikisht më të favorshëm (40 pikë), përmbushjes së specifikave teknike (40 pikë), dhe kohës së liferimit (20 pikë).

